



**Institucioni :** Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këto pozita:

**KONKURS**

**Titulli i punës :** Zyrtar për të Hyrat Financiare

**Nr.ref.** RN00004808

**Kategoria funksionale :** Niveli Profesional

**Koeficienti :** 7

**Lloji i pozitës :** I karrierës

**Orët e punës :** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** 1 vitë periudha provuese

**Vendi i punës :** Prishtinë

**Mbikëqyrës:** Drejtori të Departamentit Financavë

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi dhe administrimi i të hyrat të ARH-ës sipas planifikimeve dhe në pajtim me legjislacionin.

**Detyrat Kryesore**

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre; 10%
- Regjistron të hyrat e ARH-ës në modulën e të hyrave dhe klasifikon ato sipas programeve dhe kodit ekonomik të të hyrave; 20 %
- Mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave e të hyrave, duke siguruar që të gjithë të dhënat që futen janë të sakta, të plota, dhe sipas afateve të caktuar; 15%
- Përgatitë dhe dorëzon deklaratat financiare (duke përfshirë raporte standarde për të hyrat vjetore) dhe siguron që të dhënat e përfshira janë të sakta dhe të plota; 15%
- Monitoron dhe menaxhon të gjitha të hyrat e pranuar nga njësitë buxhetore duke siguruar që llogaritë janë dorëzuar me saktësi dhe brenda afateve kohore; 15%
- Siguron që raportet për të hyrave vjetore të hartohen dhe lëshohen në mënyrë të rregullt, sipas standardeve dhe në përputhje me kërkesat e bëra; 10%
- Barazon të hyrat e institucionit me thesarin dhe bankat në baza mujore dhe sipas periudave të raportimit si dhe koordinon punën me programet që kërkojnë t'i shpenzojnë të hyrat vetjake për çdo vit fiskal; 10%;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen

në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

### **Shkathtësitë e kërkuara**

- Diplomë universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme, 2 vite përvojë profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

**Titulli i punës :** Zyrtar për Interoperabilitet

**Nr.ref.** RN00004809

**Kategoria funksionale :** Niveli Profesional

**Koeficienti :** 7

**Lloji i pozitës :** I karrierës

**Orët e punës :** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** 1 vitë periudha provuese

**Vendi i punës :** Prishtinë

**Mbikëqyrës:** Drejtori të Departamentit Interoperabilitetit

**Qëllimi i vendit të punës:** Të ndihmoj në mbarëvajtjen e procesit të inspektimit dhe regjistrimit të inspektimeve të interoperabilitetit

### **Detyrat Kryesore**

- Inspektimi dhe raportimi për interoperabilitet;
- Të ndihmojë në dizajnin, ndërtimin, vënien në shërbim, përmirësimin, renovimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit hekurudhor
- Të bëjë kualifikimin profesional dhe kushtet shëndetësore dhe të sigurisë të personelit i cili kontribuon në operimin dhe mirëmbajtjen e tij;
- Te ndihmoje që nënsistemet të përputhet me kërkesat për interoperabilitet;
- Te ndihmoje ne përgatitjen e kërkesave esenciale për nënsistemet, ndërlidhjet dhe përbërësit e interoperabilitetit;
- Të ndihmoje në mbikëqyrjen që nënsistemet hekurudhore, ndërlidhjet dhe përbërësit e interoperabilitetit janë në përputhje kërkesat esenciale;
- Të bëjë numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë sipas ligjit në fuqi; dhe
- Të kryej punë tjera të cilat caktohen nga mbikëqyrësi.

### **Shkathësitë e kërkua**

- Diplomë universitare, drejtimi Ekonomik, Inxhinieri, 2 vite përvojë;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën që ndërlidhet me vendin e punës;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit)

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurrenca.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurrenca. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.